# DËSHMI ARKIVI

**A-471980**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tension i lartë për Izrael-Irlandë/ Protesta, bojkot dhe konferenca shtypi të shtyra, por në fund sfida do të zhvillohet |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/26/tension-i-larte-per-izrael-irlande-protesta-bojkot-dhe-konferenca-shtypi-te-shtyra-por-ne-fund-sfida-do-te-zhvillohet/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 15:58:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 15:56:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 15:55:00 UTC → 26 shtator 2026, 15:57:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `19e90ed3cac7ebc4b32d242ca4054f7880e421f9a474602e837b3aa5e0d52cbd` |
| TEKSTI | `d56101aa575f4b606a7f2303a3fd8fab27247ac38ea09b3f764cc9819526f310` |
| PAMJA | `dca0ecb4aae5447b0859076c697029eb88b14ebedd29f3413476cb4271fdcdeb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8d3e929fe34ca42fdccc1abe91fa373dcc33a74cf693586e24de49530547c58c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8d3e929fe34ca42fdccc1abe91fa373dcc33a74cf693586e24de49530547c58c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL SPORT TË FUNDIT

# Tension i lartë për Izrael-Irlandë/ Protesta, bojkot dhe konferenca shtypi të shtyra, por në fund sfida do të zhvillohet

26/09/2026 17:56



**Tensionet rreth ndeshjes së Nations League mes Izraelit dhe Irlandës e programuar për t'u luajtur të dielën në Debrecen në Hungari ishin shumë ta larta. Portieri rezervë i Irlandës, Gavin Bazunu fillimisht kishte shprehur vullnetin për të mos luajtur dhe veprimin e tij ishin gati ta ndiqnin edhe 4 futbollistë të tjerë.**

Skuadra irlandeze është bërë objekt i presioneve gjithnjë e më shumë në rritje në vend, ku solidariteti me palestinezët është shumë i fortë, teksa i kërkohet bojkoti i të dyja ndeshjeve me Izraelin, e para është e programuar pikërisht këtë të dielë. Por në fund ndeshja do të zhvillohet rregullisht edhe pse konferenca për shtyp në prag të kësaj ndeshjeje u shty dhe skuadra e zhvilloi vonë stërvitjen.

Pesë orë pas orarit fillestar të konferencës së parashikuar për shtyp, Shefi Ekzekutiv i Federatës Irlandeze të Futbollit David Courrell konfirmoi se pas një votimi, skuadra vendosi që të luajë ndeshjen.

*'Një futbollist i tha trajnerit se nuk ndihej komod në zhvillimin e kësaj ndeshjeje dhe tregoi se kishte ndërmend të linte skuadrën*-deklaroi Courell-*siç është e lehtë të imagjinohet, ky variabël i ri kërkoi kohë dhe reflektim nga pjesa tjetër e skuadrës'.*

Courell tha se u zhvillua një votim nga futbollistëve ku një shumicë dërrmuese u shpreh në favor të zhvillimit të kësaj ndeshjeje. *'Pas së gjithë kësaj, Federata, në emër të futbollit irlandez vendosi që të konfirmojë zhvillimin e sfidës duke qenë koherentë me vullnetin tonë për të respektuar gjithnjë impenjimet në kalendar*-vijoi Courrell

Përpara disa ditësh trajneri Hallgrimson shkaktoi një zemërim të madh në Izrael për një deklaratë të tij.

*'Nuk luajmë me gjenocidin, luajmë kundër gjenocidit. Luajmë kundër Izraelit, jo me Izraelin*-ishin fjalët e teknikut të Irlandës, që shtynë Federatën Izraelite të Futbollit të reagojë ashpër duke e përkufizuar trajnerin islandez si budalla, injorant dhe hipokrit.

Kujtojmë se Irlanda është në një grup me Kosovën në Nations League së bashku me Austrinë dhe pikërisht Izraelit dhe në ndeshjen e zhvilluar kundër Dardanëve ajo u mposht 1-0 kur për Kosovën golin e shënoi Vedat Muriqi.

**Top Channel**

## Futboll »


## SPORT • KRYESORE



Analiza/ Endi Tufa: Sonte nuk luajnë vetëm 11-të, sonte luajmë të gjithë



Surpriza e Maranit para Bjellorusisë, 4 lojtarë kuqezi mbeten jashtë...



La pas Skelën, Bogdanin e Salihin, zbuloni sulmuesin që dominon historinë e rrjetave ndaj bjellorusëve



Ja 11 "luftëtarët" kuqezi të zgjedhur për të marrë tri pikët me çdo kusht mbrëmjen e sotme



Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia njofton masat që do merren për garantimin e sigurisë gjatë saj

## ME TË LEXUARAT

Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij

'Gjërat nuk janë mirë, besoj se do të kthehet në shtëpi'/ Zidane e parandieu, Federata Franceze



Top News – 'Ndërkombëtarët po njohin Ramën', Berisha: Po mësohet e vërteta për padrinon e krimit

Top News – Berisha i uron mirëseardhjen ambasadorit: SHBA do ndihmojë në çmontimin e narkoshtetit

Top News – 'SPAK nuk guxon ta thërrasë Ramën', Berisha: Kam prova direkte për të




**© Top Channel 2001 - 2026 · Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.